




Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Administratës Publike - Ministarstvo Javnih Administracija - Ministry of Public Administration*

## Seria 5: Statistikat Sociale

# Anketa e Buxhetit të Ekonomive Familjare 2008



Enti i Statistikës së Kosovës  
Zavod za Statistiku Kosova  
Statistical Office of Kosovo






Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Administratës Publike - Ministarstvo Javnih Administracija - Ministry of Public Administration*

## Seria 5: Statistikat Sociale

# Anketa e Buxhetit të Ekonomive Familjare 2008



Enti i Statistikës së Kosovës  
Zavod za Statistiku Kosova  
Statistical Office of Kosovo

Botuesi: Enti i Statistikës së Kosovës (ESK)

Data e botimit: Korrik 2009

© : Enti i Statistikës së Kosovës

Riprodhimi autorizohet nëse tregohet burimi.

E shtypur nga: K.G.T, Prishtinë, Kosovë

Informata të shumta janë në dispozicion në internet,  
ku mund të qaseni përmes veb-faqes së ESK-së  
në internet: [www.ks-gov.net/esk](http://www.ks-gov.net/esk)

## Parathënie

Qëllimi i publikimit të rezultateve të Anketës së Buxhetit të Ekonomive Familjare (ABEF), 2008 është që të ofrojmë të dhëna statistikore lidhur me të ardhurat, konsumin si dhe të dhëna statistikore për çështjet tjera të ngjashme që kanë të bëjnë me standardin jetësor të ekonomive familjare në Kosovë.

Në këtë publikim janë paraqitur rezultatet në formë përmbledhëse për konsumin, shpenzimet dhe të ardhurat e ekonomive familjare për periudhat 2006 - 2008. Për grumbullimin e të dhënave, Enti Statistikor i Kosovës (ESK), përkatësisht Departamenti i Statistikave Sociale (DSS) ka përdorur ABEF.

Përmes këtij publikimi është synuar zbutja e mungesës së informacioneve në fushën e standardit jetësor të ekonomive familjare në Kosovë. Besojmë se ky publikim do të shërbejë si një bazë e dobishme referuese për të gjithë shfrytëzuesit e të dhënave statistikore.

Ftojme të gjithë shfrytëzuesit e këtij publikimi nëse kanë komente, propozime apo vërejtje që kontribuojnë në ngritjen e cilësisë së publikimit në të ardhmen, të na dërgohen në adresën: [social@ks-gov.net](mailto:social@ks-gov.net), me çka këto do të kontribuojnë në ngritjen e kualitetit të publikimit të rezultateve të ABEF në të ardhmen.

Në përgatitjen e këtij publikimi kanë kontribuar:

1. Mr. sc. Bashkim BELLAQA – Drejtor i Departamentit të Statistikave Sociale,
2. Emine DELIU – Shefe e Sektorit të Standardit Jetësor
3. Bekim CANOLLI – Shef i Divizionit të Metodologjisë,
4. Besa HAQIFI – Zyrtare e lartë e Sektorit të Standardit Jetësor,
5. Hatixhe JANUZAJ - Zyrtare e Sektorit të Standardit Jetësor, dhe
6. Mevlyde DEHARI - Zyrtare e Sektorit të Standardit Jetësor .

Dizajni: Ahmet CAKOLLI

Përkrahje profesionale për zhvillimin e ABEF, kanë ofruar Organizata Suedeze (SIDA) dhe Banka Botërore (BB). Për mbështetje profesionale të këtij publikimi veçanërisht falënderojmë ekspertet e organizatës Suedeze SIDA z. Lars Lundgren dhe z. Claes Andersson si dhe ekspertet nga Banka Botërore z. Andrew Dabalen dhe znj. Anna Gueorgueva. Nga stafi tjetër i ESK-së, në nivel regjional falënderojmë punëtorët e zyrave rajonale që kanë kontribuar në grumbullimin e të dhënave të ABEF .

Korrik , 2009

Kryeshefi Ekzekutiv i ESK-së,  
Avni Kastrati

## **Lista e shkurtesave**

ABEF	Anketa e Buxhetit të Ekonomive Familjare
SIDA	Agjencioni Ndërkombëtar për Zhvillim dhe Bashkëpunim
BB	Banka Botërore
ESK	Enti i Statistikës së Kosovës
DSS	Departamenti i Statistikave Sociale
IÇK	Indeksi i Çmimeve Konsumuese
LLK	Llogaritë Kombëtare
BE	Bashkimi Evropian
KKIQ	Klasifikimi i Konsumit Individual sipas Qëllimit

## P ë r m b a j t j a

Faqe

H Y R J E.....	5
1 Konsumi i ekonomive familjare në Kosovë 2006 – 2008 .....	6
1.1 Konsumi i përgjithshëm.....	7
1.2 Ushqimi.....	8
1.3 Banimi.....	9
1.4 Rrobat dhe veshmbathjet.....	10
1.5 Transporti .....	10
1.6 Mobiliet .....	11
1.7 Konsumi kryesor ( pesë grupet më të mëdha) .....	11
1.8 Alkooli dhe duhani .....	12
1.10 Komunikimi .....	13
1.11 Rekreacioni.....	14
1.12 Arsimi.....	14
1.13 Hotele dhe restorante .....	15
1.14 Mallrat të tjera .....	15
1.15 Konkluzion .....	16
2 Konsumi i përgjithshëm në Kosovë 2006 - 2008 .....	18
2.1. Trendet e konsumit .....	18
3 Të hyrat private në Kosovë 2006 - 2008 .....	21
3.1. Të hyrat kryesore të ekonomive familjare .....	21
3.2 Burimet e të hyrave individuale .....	22
3.3 Struktura gjinore .....	24





## HYRJE

ABEF është një vrojtim statistikor që kryhet për të marrë të dhëna mbi shpenzimet për konsum, vetëkonsum, të ardhurat e familjeve dhe ambientin bazë socio-ekonomik në të cilin familjet jetojnë. Anketa siguron gjithashtu të dhëna mbi disa tregues të rëndësishëm mbi kushtet e jetesës (banimin, posedimin e pajisjeve afatgjata në familje, kushtet e ngrohjes, udhëtimet dhe/ose pushimet vjetore), si edhe të dhëna mbi karakteristikat bazë demografike, ekonomike dhe sociale të familjeve.

Të dhënat e mbledhura përmes ABEF do të sigurojnë gjithashtu informacion mbi nivelin e jetesës, masën dhe përbërjen e shpenzimeve dhe konsumit total të familjeve dhe karakteristika socio-ekonomike të tyre. Një nga objektivat specifike të Anketës së Buxhetit të Familjes është marrja e të dhënave të nevojshme për vlerësimin e peshave të cilat përdoren për llogaritjen e indeksit të çmimeve të konsumit. Gjithashtu, kjo anketë siguron të dhëna që do të përdoren si një input për matjen e konsumit privat në Llogaritë Kombëtare (LLK) të familjeve si dhe për analizimin e mirëqenies dhe varfërisë në nivel vendi brenda periudhës kohore të përcaktuar.

Të dhënat janë mbledhur në tërë Kosovën gjatë një viti duke përfshirë 2.400 ekonomi familjare në vit të zgjedhura sipas metodës së rastit dhe në pajtim me standardet e Bashkimit Evropian (BE) dhe praktikat më të mira ndërkombëtare. Shkalla e përgjigjeve është rreth 80 % nëse ekonomitë familjare të zëvendësuar janë konsideruar se nuk kanë dhënë përgjigje.

Progresi ekonomik në vitet e fundit do të definohej si përmirësim i kushteve të jetesës në krahasim me periudhën menjëherë pas luftës. Në këto rrethana, ABEF është e mirëseardhur për matjen e standardit jetësor, për matjen e Bruto Produktit Vendor (BPV) si dhe fitimin e ponderave të çmimeve konsumuese.

Mostra e ABEF ka shtrirje në zonat urbane dhe rurale, në tërë territorin e Kosovës. Përpunimi dhe analizimi i të dhënave është bërë përmes programeve ACCESS dhe SPSS. Pyetësi përmbante informata mbi përbërjen demografike të ekonomisë familjare duke përfshirë të dhëna individuale mbi secilin anëtar të ekonomisë familjare, si dhe të ardhurat, konsumin dhe shpenzimet, kushtet e banimit, aktivitete në biznese dhe bujqësi, qasjen në infrastrukturën themelore dhe në shërbimet publike, etj.

## **1 Konsumi i ekonomive familjare në Kosovë 2006 – 2008**

Dihet se konsumi është pjesë e rëndësishme e jetës së popullatës, pra niveli i konsumit dhe përmasat e tij janë qenësore për mirëqenien, ndërsa pasuria dhe varfëria varen nga aspektet tjera në jetë. Të dhënat për konsum miren nga ekonomitë familjare, përderisa të hyrat fitohen nga individët. Alkooli dhe duhani, veshmbathjet, rekreacioni dhe disa gjëra tjera specifike mund të konsumohen individualisht, por pjesa më e madhe, si ushqimi, banimi dhe furnizimi shfrytëzohen së bashku nga pjesëtarët e ekonomive familjare.

Konsumi klasifikohet sipas Standardit të Klasifikimit të Konsumit Individual sipas Qëllimit (KKIQ) në harmonizim me Llogaritë Kombëtare dhe Indeksin e Çmimeve Konsumuese. Përveç disa përmirësimeve, standarde të njëjta janë aplikuar gjatë viteve, duke e bërë atë të krahasueshëm më lehtë gjatë kohës.

Shumica e konsumit bazohet në mallrat e blera dhe shërbimet e paguara gjatë periudhës së referuar, dhe një pjesë më e vogël në mallrat të vetprodhuara. Periudha e referuar është një muaj për konsumin ditor (të mbështetur me mbajtjen e shënimeve) dhe 12 muajt e fundit për mallrat e qëndrueshme.

Në këtë dokument ne do të fokusohemi në nivelin e konsumit për grupe të ndryshme konsumuese (ushqim, veshmbathje, banim, etj.) dhe pjesëmarrjen e tyre në konsumin e përgjithshëm. Ekonomitë familjare me arsim të lartë dhe ekonomitë familjare urbane mund të shihen si treguese për zhvillimin e ardhshëm të konsumit, pasi që gjithnjë e më shumë njerëzit po arsimohen dhe Kosova është duke u urbanizuar.

Shifrat në tekst janë rumbullakuar që të sinjalizojnë se një mostër anketë mund t'i japë vetëm vlerat e përafërta.


## 1.1 Konsumi i përgjithshëm

Konsumi për ekonomi familjare gjatë vitit 2008 në Kosovë ka qenë 6.707 €, nga kjo vërehet se ka pasur rritje prej 17 përqind (%) në krahasim me vitin 2007.

Gjatë vitit 2008 ekonomitë familjare urbane kanë pasur një konsum më të lartë, 6.894 €, ndërsa konsumi në ekonomitë familjare rurale ka qenë 6.536 €. Ekonomitë familjare me kryefamiljarët që kanë përfunduar vetëm arsimin fillor apo më pak, konsumojnë rreth 5.986 €, ndërsa ato me arsimim të mesëm konsumojnë 6.789 € si dhe ato me arsim të lartë 8.656 €. Ekonomitë familjare rurale dhe më pak të arsimuara kanë pasur nivel më të ulët të konsumit dhe më shumë pjesëtarë për ta ndarë atë.

Sipas rezultateve të dalura të ABEF, për vitin 2008, konsumi i përgjithshëm është rritur te ekonomitë familjare që kanë arsimim më të lartë.

**Figura 1: Konsumi i përgjithshëm vjetor i ekonomive shtëpiake sipas lokalitetit dhe nivelit të arsimit 2006-2008**




## 1.2 Ushqimi


Pjesa më e madhe e buxhetit të ekonomive familjare shfrytëzohet për ushqim dhe është llogaritur 2.581 € për vitin 2008 apo 38 përqind (%) të konsumit të përgjithshëm, që paraqet rritje prej 13 përqind (%) krahasuar me vitin 2007. Pjesa më e vogël e buxhetit e shpenzuar për ushqim tregon një mirëqenie më të lartë.

Pjesa për ushqim ka qenë ndërmjet 10% dhe 19% në shtetet anëtare të EU në vitin 1999.

**Figura 2: Konsumi vjetor i ushqimit nga ekonomitë familjare sipas lokalitetit dhe nivelit arsimit 2006-2008 në €**



**Figura 3: Pjesëmarrja e ushqimit në konsumin e përgjithshëm sipas lokalitetit dhe nivelit të arsimit 2006-2008 në %**




### 1.3 Banimi

Banimi përbën pjesën e dytë më të madhe të buxhetit të ekonomive familjare me 2.324 € apo 35 përqind (%) të buxhetit të ekonomive familjare, që paraqet rritje prej 27 përqind (%) krahasuar me vitin 2007. Pjesa e buxhetit e cila është ndarë për banim sillet nga 28 përqind (%) për ekonomitë familjare rurale, deri 37 përqind (%) për ato urbane.

Në vitin 1999 banimi në shtetet anëtare të BE-së ka qenë nga 20 - 31 përqind (%). Ushqimi dhe banimi së bashku përbëjnë më shumë se dy të tretat apo 73 përqind (%) të buxhetit të ekonomive familjare.

Pjesa më e madhe e banimit është "qiraja e vlerësuar". Një pjesë e vogël e ekonomive familjare paguajnë qira.


**Figura 4: Shpenzimet për banim të ekonomive familjare sipas lokalitetit dhe nivelit të arsimit 2006-2008 në €**



## 1.4 Rrobat dhe veshmbathjet

Një ekonomi familjare mesatarisht shpenzon rreth 300 € në vit për rroba dhe veshmbathje apo 5 përqind (%) të buxhetit. Ekonomitë familjare me arsim më të lartë shpenzojnë më shumë për rrobat dhe veshmbathjet, rreth 420 €, apo 14 përqind (%) më shumë. Pjesa e buxhetit që ndahet për rroba sillet prej 5 -6 %, krahasuar me 5 – 9 % brenda BE-së në 1999.


**Figura 5: Shpenzimet për rroba dhe veshmbathje të ekonomive familjare sipas lokalitetit dhe nivelit arsimit 2006-2008 në €**



## 1.5 Transporti

Transporti ka pasur ngritje gjatë vitit 2008, në krahasim me vitin 2007, për 26 përqind (%). Pjesa e buxhetit e ndarë për transport në vitin 2008 ka qenë 4 përqind (%) për ekonomitë familjare urbane ndërsa 6 përqind (%) për ato rurale. Ekonomitë familjare me arsimim të lartë shfrytëzojnë 5 përqind (%) të buxhetit të tyre në transporte. Në BE në vitin 1999 pjesa e buxhetit për transporte ka qenë ndërmjet 10 e 17 përqind (%).

**Figura 6: Shpenzimet e transportit të ekonomive familjare sipas lokalitetit dhe nivelit të arsimit 2006-2008 në €**




### 1.6 Mobilitet

Prej vitit 2006 deri 2007 është evidente një rënie e shpenzimeve për mobilie, ndërsa në vitin 2008 ekonomitë familjare mesatarisht ka shpenzuar rreth 227 € në vit, apo 8 përqind (%) më shumë krahasuar me vitin 2007. Ekonomitë familjare me arsim të lartë mesatarisht kanë shpenzuar 245 € në vit.

Pjesa e buxhetit e ekonomive familjare e ndarë për mobile ishte rreth 3 % në vitin 2008, ndërsa në vendet e BE ishte 5 - 8 % në vitin 1999.


**Figura 7: Mobilitet sipas lokalitetit dhe nivelit arsimit 2006-2008 në €**



### 1.7 Konsumi kryesor ( pesë grupet më të mëdha)

Pesë kategoritë kryesore të konsumit më të lartë (ushqimi, banimi, transporti, rrobat dhe veshmbathjet, si dhe mobileje) paraqesin 86 % përqind të konsumit të përgjithshëm. Shtatë kategoritë tjera të konsumit e ndajnë 14 % përqind të konsumit.


**Figura 8: Pesë kategoritë kryesore të konsumit të ekonomive familjare sipas lokalitetit dhe nivelit të arsimit , % e përgjithshme**



## 1.8 Alkooli dhe duhani

Në buxhetin e përgjithshëm të ekonomisë familjare alkooli dhe duhani marrin pjesë 3 përqind %, apo 205 € në vit. Po të krahasojmë me dy vitet paraqake, konsum ka pasur rritje në vitin 2006, ndërsa në vitet 2007 dhe 2008 është evidente një rënie konstante. Në vendet e BE konsum i alkoolit dhe duhanit sillet ndërmjet 2 deri në 7 % përqind.

**Figura 9: Konsumi i Alkoolit dhe duhanit të ekonomive familjare sipas lokalitetit dhe nivelit të arsimit 2006-2008, në €**



**Tabela1: Përqindja e duhanxhinjve në popullatë në vitin 2008 sipas gjinisë dhe konsumit ditor të cigareve , % e popullatës në moshën 10 vjeçare dhe më të moshuara**


Nr. i cigareve	Meshkujt		Femrat		Të gjithë	
	2007	2008	2007	2008	2007	2008
1 deri 10	2	2	2	2	2	2
11 deri 20	21	17	4	3	12	10
21+	4	4	0	0	2	2
Nr. përgj. i duhanxhinjve	27	23	6	5	16	14



## 1.9 Shëndetësia

Shpenzimet për shëndetësi janë rritur për 5 % përqind krahasuar me vitin 2007. Ekonomitë familjare me arsimim fillor në vitin 2007 kanë shpenzuar më shumë për shëndetësi se sa ato me nivel më të lartë të arsimit. Në vitin 2008 krahasuar me vitin 2007 familje me arsim të lartë kanë shpenzuar për shëndetësi rreth 20% përqind më shumë.


**Figura 10: Shpenzimet për shëndetësi të ekonomive familjare sipas lokalitetit dhe nivelit arsimit 2006-2008, në €**



## 1.10 Komunikimi

Shpenzimet për komunikim kanë pasur rritje në vitin 2006, por në vitin 2007 vërehet një rrënjë. Në vitin 2008 ekonomitë familjare kanë pasur një rritje të vogël prej 3 % përqind në krahasim me vitin 2007. Ekonomitë familjare urbane dhe ato me shkollim të lartë shpenzojnë më shumë për komunikim krahasuar me grupet tjera.


**Figura 11: Shpenzimet e komunikimit të ekonomive familjare sipas lokalitetit dhe nivelit arsimit 2006-2008, në €**



### 1.11 Rekreacioni

Në vitin 2008 ekonomitë familjare urbane kanë shpenzuar më tepër për rekreacion në krahasim me vitin 2007. Niveli i shpenzimeve pothuajse në të gjitha grupet e ekonomive familjare ka qenë më i lartë në vitin 2006, në krahasim me vitet 2007 dhe 2008.


**Figura 12: Shpenzimet për rekreacion sipas lokalitetit dhe nivelit të arsimit 2006-2008, në €**



### 1.12 Arsimi

Shpenzimet për arsim kanë qenë më të ulëta në vitin 2007 në krahasim me vitin 2008, sidomos ekonomitë familjare me arsimim të mesëm. Në vitin 2008, ekonomitë familjare me arsim të lartë kanë pasur rritje të dukshme të shpenzimeve për arsim në krahasim me vitin 2007.


**Figura 13: Shpenzimet për arsim të ekonomive familjare sipas lokalitetit dhe nivelit të arsimit 2006-2008, në €**



### 1.13 Hotele dhe restorante

Në vitin 2007, shpenzimet për hotele dhe restorante janë zvogëluar në krahasim me shpenzimet e vitit 2006, përveç shpenzimeve në vise urbane që kanë shënuar një rritje të dukshme. Në vitin 2008 shpenzimet për hotele dhe restorante kanë qenë më të mëdha te ekonomitë urbane dhe me arsim të lartë, por në krahasim me vitin 2007 është evidente rritje e këtyre shpenzimeve në viset rurale dhe në ekonomitë familjare me arsim të mesëm dhe fillor.


**Figura 14: Shpenzimet për hotele dhe restorante të ekonomive familjare sipas lokalitetit dhe nivelit arsimit 2006-2008, në €**



### 1.14 Mallrat të tjera

Ky grup është një përzierje e mallrave për rregullim të flokëve, mallrave për nevoja personale, shpenzime për sigurime dhe shpenzime tjera financiare. Ekonomitë familjare në vitin 2008 krahasuar me vitin 2007 kanë pasur një rritje prej 22 përqind (%).

**Figura 15: Shpenzimet tjera të ekonomive familjare sipas lokalitetit dhe nivelit të arsimit 2006-2008, në €**



## 1.15 Konkluzion

Ekonomia familjare kosovare ngadalë po transformohet nga dominimi i ushqimit në banim, veshmbathje dhe transport. Ekonomitë familjare urbane dhe ato me arsim të lartë janë më përpara në këtë aspekt dhe po e rrisin pjesën e buxhetit për komunikacion, arsim, rekreacion dhe hotele e restorante.

**Tabela 2: Konsumi vjetor i ekonomive shtëpiake në Kosovë 2006-2008 sipas të konsumit, lokalitetit dhe arsimit të kryefamiljarëve të ekonomive familjare, € të konsumit të përgjithshëm**

Vitet	Ushqimi	Alko & duhan	Veshmb	Banim	Mobileje	Shënd	Transp	Komu	Rekre	Arsim	Hotel & rest	Të tjera	Totali €
2006	2 222 €	220	317	1 779 €	219	119	327	129	74	45	113	157	5 721 €
2007	2 282 €	206	296	1 833 €	210	145	285	111	69	36	103	145	5 721 €
2008	2 581 €	205	309	2 324 €	227	152	358	114	73	75	111	178	6 707 €
Urbane													
2006	2 241 €	224	228	2 227 €	209	108	291	176	82	42	102	158	6 088 €
2007	2 144 €	210	281	2 286 €	198	136	262	147	77	29	171	173	6 144 €
2008	2 399 €	204	283	2 388 €	214	142	331	138	81	87	152	174	6 894 €
Rurale													
2006	2 211 €	230	327	1 532 €	225	125	347	102	69	46	98	157	5 469 €
2007	2 384 €	202	307	1 503 €	219	152	303	85	63	40	53	125	5 436 €
2008	2 744 €	205	332	1 997 €	238	161	382	91	66	64	73	181	6 536 €
Arsim fillor apo më pak													
2006	2 186 €	262	332	1 635 €	222	131	319	110	67	35	78	166	5 543 €
2007	2 199 €	207	283	1 695 €	226	155	233	89	58	43	52	140	5 380 €
2008	2 437 €	220	298	1 987 €	202	142	308	93	53	39	59	150	5 986 €
Arsim të mesëm													
2006	2 197 €	215	322	1 826 €	212	97	331	134	77	44	139	151	5 745 €
2007	2 297 €	210	301	1 835 €	199	133	294	112	63	27	109	138	5 718 €
2008	2 572 €	200	300	2 393 €	232	146	388	118	73	72	118	179	6 789 €
Arsim të lartë													
2006	2 332 €	170	454	2 556 €	275	149	505	226	170	109	339	270	7 555 €
2007	2 542 €	160	373	2 730 €	228	135	395	192	123	58	314	222	7 472 €
2008	2 910 €	164	426	3 309 €	245	162	417	188	130	185	303	216	8 656 €

**Tabela 2a: Konsumi vjetor i ekonomive familjare në Kosovë 2006-2008, sipas 5 grupeve kryesore të konsumit, lokalitetit dhe arsimit të kryefamiljarëve të ekonomive familjare, në përqindje (%)**

Vitet	Ushqimi	Alko & duhan	Veshmb	Banim	Mobileje	Shënd	Transp	Komu	Rekre	Arsim	Hotel & rest	Te tjera	15-Grupet kryesore %
2006	39%	4%	6%	31%	4%	2%	6%	2%	1%	1%	2%	3%	86%
2007	40%	4%	5%	32%	4%	3%	5%	2%	1%	1%	2%	3%	86%
2008	38%	3%	5%	35%	3%	2%	5%	2%	1%	1%	2%	3%	86%
Urbane													
2006	37%	4%	4%	37%	3%	2%	5%	3%	1%	1%	2%	3%	86%
2007	35%	3%	5%	37%	3%	2%	4%	2%	1%	0%	3%	3%	84%
2008	35%	3%	5%	37%	3%	2%	4%	4%	1%	0%	3%	3%	86%
Rurale													
2006	40%	4%	6%	28%	4%	2%	6%	2%	1%	1%	2%	3%	84%
2007	44%	4%	6%	28%	4%	3%	6%	2%	1%	1%	1%	2%	88%
2008	44%	4%	6%	28%	4%	3%	6%	2%	1%	1%	1%	2%	87%
Arsim fillor apo më pak													
2006	39%	5%	6%	29%	4%	2%	6%	2%	1%	1%	1%	3%	84%
2007	41%	9%	5%	32%	4%	3%	4%	2%	1%	1%	1%	3%	86%
2008	41%	9%	5%	32%	4%	3%	4%	2%	1%	1%	1%	3%	87%
Arsim të mesëm													
2006	38%	4%	6%	32%	4%	2%	6%	2%	1%	1%	2%	2%	86%
2007	40%	4%	5%	32%	3%	2%	5%	2%	1%	0%	2%	2%	85%
2008	40%	4%	5%	32%	3%	2%	5%	2%	1%	0%	2%	2%	86%
Arsim të lartë													
2006	31%	2%	6%	34%	4%	2%	7%	3%	2%	1%	4%	4%	82%
2007	34%	2%	5%	37%	3%	2%	5%	3%	2%	1%	4%	3%	84%
2008	34%	2%	5%	37%	3%	2%	5%	3%	2%	1%	4%	3%	84%

<sup>1</sup> Këtu janë përfshirë pesë grupet kryesore të konsumit (ushqimi, banimi, transporti, rrobat dhe veshmbathjet, mobilie).

## 2 Konsumi i përgjithshëm në Kosovë 2006 - 2008

Ky publikim paraqet të dhënat makroekonomike të ABEF për vitin 2006 - 2008.

Në disa raste rezultatet ndryshojnë nga Llogaritë Kombëtare (LLK-të), pasi që LLK-të plotësohen më disa burime tjera të të dhënave (si p.sh. të dhëna prej doganave, të dhëna nga importi dhe të dhëna tjera nga prodhimi vendor) dhe bëjnë disa përshtatje.

Të dhënat janë grumbulluar sipas standardit ndërkombëtar të Klasifikimit të Konsumit Individual sipas Qëllimit (KKIQ). Më një mostër paksa më të vogël rezultatet duhet të konsiderohen si të përafërta. Pa një regjistrim të ri të përgjithshëm të popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave është vështirë që të bëhet ndonjë vlerësim.

### 2.1. Trendet e konsumit

Sipas rezultateve të dalura të ABEF- 2008, shënon një rritje prej 28 përqind (%) të konsumit krahasuar me vitin 2007, ndërsa te konsumi për ekonomitë familjare një rritje prej 18 përqind (%) dhe konsumi për kokë banori 17.5 përqind (%).

**Tabela 3: Konsumi i përgjithshëm në Kosovë 2006-2008**

Viti	Milion €	Konsumi për ekonomitë familjare €	Konsumi për banor €
2006	1. 414	5. 700	980
2007	1. 403	5. 700	980
2008	1. 798	6. 707	1 156

## 2.2. Shpërndarja e konsumit

Pjesa më e madhe e buxhetit të ekonomive familjare është shpenzuar në ushqim, apo 38 % përqind të konsumit të përgjithshëm. E dyta është banimi me 35 % përqind dhe vendin e tretë e zënë transporti dhe veshmbathja me 5 % përqind. Shpenzimet për ushqimin janë zvogëluar në krahasim me vitin 2007 dhe kjo mund të shihet si një shenjë e një standardi më të lartë ekonomik.

Në vitin 2008 rreth 8 % përqind e konsumit të përgjithshëm përfshinë ushqimin nga prodhimi vetanak.

**Tabela 4: Shpërndarja e konsumit në Kosovë 2006-2008**

(%)

Konsumi	2006	2007	2008
Ushqimi	39	40	38
Alkool & Duhan	4	4	3
Veshmbathja	5	5	5
Banimi	31	32	35
Mobileje	3	4	3
Shëndetësi	2	3	2
Transport	6	5	5
Komunikim	2	2	2
Rekreacion	1	1	1
Edukim	1	1	1
Hotel & Restorante	2	2	2
Të tjera	3	3	3
<b>Gjithsej</b>	<b>100</b>	<b>100</b>	<b>100</b>
<i>Ushqimi i prodhuar vendor</i>	7	8	8

**Tabela 5: Shpërndarja e konsumit në BE në vitin 1999**

(%)

Konsumi	Min	Maks
Ushqimi	10	19
Alkooli & duhani	2	7
Rrobat	5	9
Banimi	20	31
Mobileje	5	8
Shëndetësia	1	6
Transporti	10	17
Komunikacioni	2	3
Rekreacioni	5	15
Arsim	0	2
Hotele & restorante	4	10
Të tjera	5	15

*Burimi: ABEF 1999, Eurostat*

Ushqimi në Kosovë dominohet nga buka, ushqimi nga drithërat, produktet ditore dhe vezët, mishi, që kontribuojnë më shumë se gjysmën e konsumimit të ushqimit (në vlerë). Më pas vinë perimet dhe pijet joalkoolike.

**Tabela 6: Shpërndarja e konsumit të ushqimit në Kosovë 2006-2008**

(%)

Konsumi	2006	2007	2008
Buka dhe drithërat	19	20	22
Mishi	19	19	18
Peshku	1	1	1
Produktet ditore, vezët	19	21	19
Vajrat dhe yndyrat	5	5	5
Frutat	6	6	6
Perimet	12	11	12
Sheqeri dhe ëmbëlsirat	5	5	4
Produktet e ushqimit	5	4	4
Pijet jo alkoolike	9	7	8
Ushqimi i përgjithshëm	<b>100</b>	<b>100</b>	<b>100</b>



### 3 Të hyrat private në Kosovë 2006 - 2008

#### 3.1. Të hyrat kryesore të ekonomive familjare

Rrogat nga sektori publik janë burimi më i rëndësishëm i të hyrave në Kosovë dhe janë burimi kryesor për gati një të katrën e ekonomive familjare.

Burimi tjetër më i rëndësishëm janë rrogat nga sektori privat si dhe bizneset. Pothuajse një nga dhjetë ekonomitë familjare jeton nga paratë e dërguara nga jashtë (remitenca).

Shumica e ekonomive familjare kanë burime të përziera të të hyrave, prandaj të hyrat e tanishme japin një pasqyrë të ndryshme.

**Tabela 7: Burimi kryesor i të hyrave për ekonomitë familjare në Kosovë, % e ekonomive familjare**

Burimi i të hyrave	2007	2008
Rrogat dhe pagat nga sektori publik	27	25
Rrogat dhe pagat nga sektori privat	21	19
Bujqësi	7	7
Të ardhurat nga mëditjet <sup>2</sup>	8	8
Biznese të tjera të ekonomive familjare	8	15
Pensionet	8	8
Të hollat e dërguara nga jashtë	11	10
Të hollat e dërguara nga Kosova	2	1
Ndihma sociale	6	5
Të tjera <sup>3</sup>	2	2
Totali	100	100

<sup>2</sup> Të hyrat nga aktivitete e painkorporuara

<sup>3</sup> Të tjera – Burimi i të hyrave jo të përcaktuar në kategoritë më lartë

### 3.2 Burimet e të hyrave individuale

Burimi kryesor i të hyrave janë rogat nga punësimi i rregullt që përbëjnë rreth gjysmën e të hyrave të përgjithshme. Rreth 5 përqind (%) janë fituar nga puna e përkohshme.

Burim i dytë janë të hyrat neto nga bizneset që përbëjnë 16 përqind (%) të të hyrave të përgjithshme dhe nga bujqësia 7 përqind (%).

Burimi tjetër i rëndësishëm janë paratë e gatshme të dërguara nga jashtë (remitenca) nga pjesëtarët e ekonomive familjare 8 përqind (%) më një shtesë prej 3 përqind (%) nga të tjerët jashtë vendit. Pensionet nga Kosova përbëjnë 5 përqind (%) dhe pensionet nga jashtë 3 përqind (%).

Femrat fitojnë vetëm 19 përqind (%) të të hyrave të përgjithshme. Rogat nga punësimi i rregullt janë më të rëndësishme për femrat sesa për meshkujt.

Pensionet nga Kosova përbëjnë burimin e dytë më të rëndësishëm për femrat me 13 përqind (%) krahasuar me vetëm 4 përqind (%) për meshkujt.

Arsimimi ka ndikim kryesor në burimet e të hyrave. Arsimimi më i madh shpie në më shumë të ardhura nga punësimi i rregullt. Ata me shkollë fillore apo më pak, në masë të konsiderueshme duhet të jetojnë nga mëditjet, pensionet nga jashtë, biznesi vetanak dhe mbështetja nga jashtë. Natyrisht ekziston një korrelacion i përafërt ndërmjet arsimimit dhe moshës. Njerëzit më shkollë të mesme sigurojnë 22 përqind (%) të të hyrave të tyre nga bizneset.

**Tabela 8: Burimet e të hyrave individuale në Kosovë, viti 2008, % e të hyrave**

Burimi i të hyrave	Meshkuj	Femra	Të gjithë
Neto rogat dhe pagesat e fituara në Kosovë, neto pa tatim	43	60	46
Pagat në natyrë	0	0	0
Të ardhurat nga mëditjet	6	1	5
Qiraja, disidentë, interesi (nga kursimi në bankë)	3	1	3
Benefitet për mirëqenie sociale	1	2	1
Pensionet nga Kosova	4	13	5
Pensionet nga jashtë Kosovës	3	3	3
Të hollat e dërguara në para të gatshme nga Kosova	1	1	1
Neto të ardhurat nga biznesi vetanak në Kosovë	19	5	16
Para të gatshme të dërguara nga jashtë nga anëtarët aktual/prezent/(pagat, transferet, etj)	8	8	8
Para të gatshmet dërguara nga diaspora nga persona të tjera	3	6	3
Dhuratat në natyrë dërguara nga diaspora	0	0	0
Të hyrat nga bujqësia	8	1	7
Të tjera	1	0	1
Totali në %	100	100	100
Totali në milion €	997 €	232 €	1.229 €

**Tabela 9: Burimet e të hyrave sipas nivelit më të lartë të arsimimit, viti 2008**

Burimi i të hyrave	Fillor	Mesëm	Universiteti ose më lartë
Neto rrogat dhe pagesat e fituara në Kosovë,neto pa tatim	26	50	79
Pagat në natyrë	0	0	0
Të ardhurat nga mëditjet	10	5	0
Qiraja,disidentë, interesi(nga kursimi në bankë)	2	3	3
Benefitet për mirëqenie sociale	3	1	0
Pensionet nga Kosova	6	2	1
Pensionet nga jashtë Kosovës	7	1	0
Të hollat e dërguara në para të gatshme nga Kosova	1	0	4
Neto të ardhurat nga biznesi vetanak në Kosovë	13	22	10
Para të gatshmet dërguara nga jashtë nga anëtarët aktual/prezent/(pagat,transferet, etj)	15	7	1
Para të gatshmet dërguara nga diaspora nga persona të tjera	5	3	1
Dhuratat në natyrë dërguara nga diaspora	0	0	0
Të hyrat nga bujqësia	10	5	1
Të tjera	1	1	0
<b>Totali</b>	<b>100</b>	<b>100</b>	<b>100</b>

### 3.3 Struktura gjinore

Femrat kanë të hyra shumë më të ulëta se meshkujt, si grup dhe si mesatare individuale. Si shpjegim mund të jetë vëllimi i ndryshëm i punëve sesa pagat e padrejta.

**Tabela 10: Të hyrat mesatare nga punësimi i rregullt 12 mujor sipas gjinisë, €**

Të Hyrat	Meshkuj	Femra	Të gjithë
Rrogat për punësim 12 mujor	3.075 €	2.694 €	52%

Prej të hyrave mestare nga punësimi prej 52 përqind (%), meshkujt fitojnë pothuajse 14 përqind % më shumë se femrat brenda periudhës 12 mujor.

**Tabela 11: Të hyrat mesatare nga punësimi 12 mujor sipas edukimit, €**

Të Hyrat	Meshkuj	Femra	Të gjithë
Rrogat për punësim 12 mujor	2.418 €	1.852 €	55%

#### Mesëm

Të Hyrat	Meshkuj	Femra	Të gjithë
Rrogat për punësim 12 mujor	2.975 €	2.478 €	53%

	Universitet ose më lartë		
Të Hyrat	Meshkuj	Femra	Të gjithë
Rrogat për punësim 12 mujor	4.151 €	3.505 €	52%



## Enti i Statistikës së Kosovës përshkrim i shkurtër

**Enti i Statistikës së Kosovës**, është Ent profesional, vepron që nga viti 1948 dhe ka kaluar disa faza historike, i strukturuar sipas rregullimit shtetëror të asaj kohe.

Më 2 Gusht 1999, Enti ka rifilluar punën profesionale, si i pavarur në kuadër të Ministrisë së Administratës Publike. Enti financohet nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës dhe donatorë për projekte të veçanta.

**Enti i Statistikës së Kosovës** vepron sipas Rregullores 2001/14 e cila ka hyrë në fuqi me 2 Korrik 2001. Një Master Plan afatmesëm është duke u përgatitur për zhvillimin e sistemit statistikor kompatibil me Statistikat Evropiane.

**Struktura organizative e ESK-së**, katër *Departamente prodhuese* (Departamenti i statistikave ekonomike dhe llogarive kombëtare, Departamenti i statistikave të popullsisë, Departamenti i statistikave sociale dhe Departamenti i statistikave të bujqësisë dhe ambientit), *shtatë Zyra Rajonale* (Gjakovë, Gjilan, Mitrovicë, Pejë, Prizren, Prishtinë dhe Ferizaj), *dy Departamente mbështetëse* (Departamenti i metodologjisë dhe teknologjisë informative dhe Departamenti i administratës), si dhe *Zyra e regjistrimit të popullsisë*, përbëjnë ndërtimin struktural të ESK-ës.

Të punësuar janë gjithsej 134 punëtorë, prej tyre, 96 (71.6%) në seli të Entit, gjersa në Zyrat Rajonale, 38 (28.4%) .

Kemi mbështetje dhe bashkëpunim profesional me institucionet ndërkombëtare.

Enti i Statistikës së Kosovës ka një terren krejtësisht të mbuluar në shkallë vendi. Për implementim e Anketave në terren përdorim mostrën dhe metodologjinë adekuate. Gjatë grumbullimit të raporteve nga njësitë raportuese angazhohen; profesionistë, teknikë, administratorë, civilë të zyrave të vendit, regjistruar terreni nga Zyrat Rajonale.

Një ekip i ekspertëve vendorë dhe ndërkombëtar janë duke punuar në projektin e regjistrimit të popullsisë.

**Misioni i Entit**, është që të përmbush nevojat e përdoruesve me të dhëna statistikore objektive dhe analiza të rregullta në mënyrë që të përkrah departamentet qeveritare, t'u sigurojë informata të duhura për vendim-marrësit si dhe përdoruesit tjerë në Kosovë.

- **Adresa:** Enti i Statistikës së Kosovës, Rr."Zenel Salihu" Nr.4, Prishtinë
- **Telefonat:**  
Qendra kryesore: +381 (0) 38 235 111  
Drejtori: +381 (0) 38 235 545
- **Fax:** +381 (0) 38 235 033
- **E-mail:** [social@ks-gov.net](mailto:social@ks-gov.net)
- **Ueb-faqe:** [www.ks-gov.net/esk](http://www.ks-gov.net/esk)